



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 203, Datë 18.12.2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT  
ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË”.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, gërma “h”; nenit 79 dhe nenit 94 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Furnksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, pasi shqyrtoi relacionin mbi “Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatoi se:**

1. Me Vendimin nr. 66, datë 27.05.2016, Bordi i ERE-s vendosi: “Fillimin e procedurave për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.
2. Me shkresën nr.429 Prot, datë 01.06.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” për opinion.
3. Në shkresën e saj me nr. 3788/1 Prot, datë 16.06.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar në vlerësim të secilës.
4. Në shkresën e saj me nr. 4528/1 Prot, datë 13.06.2016, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të cilat janë reflektuar në draftin e këtij akti.
5. Në shkresën me nr.A-DO/3391/1 Prot, datë 24.06.2016, shoqëria “OST” sh.a ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me

energji elektrike për klientët fundorë”, të cilat janë reflektuar në këtë akt për aq sa janë gjendur në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë “Kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.( Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë te interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**